




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Datë: 23/01/2026

UDHËZUES PËR APLIKANTË

**për Thirrje Publike për Mbështetje Financiare të Projekteve
në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

Qëllimi

1. Ky Udhëzues për Aplikantë ka për qëllim të përcaktojë rregullat, kriteret dhe procedurat për aplikim në Thirrjen Publike për mbështetje financiare të projekteve nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) e Komunës së Skenderajt.
- Ky udhëzues është hartuar në përputhje me Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Rregulloren Komunale për ndarje të Subvencioneve

Baza Ligjore

Ky Udhëzues bazohet në:

- Rregulloren MF Nr. 04/2017;
- Rregulloren Komunale për ndarje të Subvencioneve 01-400/0-005/689/20

FUSHAT E MBËSHTETJES

Fushat Prioritare

1. Projektet që aplikojnë duhet të jenë në njërin nga fushat në vijim:
 - o Kulturë
 - o Rini
 - o Sport
2. Projektet duhet të kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e komunitetit të Komunës së Skenderajt.

APLIKANTËT E KUALIFIKUAR

E Drejta e Aplikimit

1. Të drejtë aplikimi kanë:
 - o Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ) të regjistruara në Republikën e Kosovës;
 - o Shoqatat dhe klubet sportive apo kulturore të regjistruara
 - o Individ me projekte në fushat e cekura

Kushtet e Përgjithshme

Aplikantët duhet:

- Të mos jenë në proces falimentimi apo shuarjeje;
- Të kenë përmbushur obligimet nga projektet e mëparshme (nëse ka);
- Të mos përfitojnë financim të dyfishtë për të njëjtin projekt.

FINANCIMI

Shuma e Mbështetjes Financiare

1. Shuma totale e fondeve të ndara për këtë Thirrje Publike është **150,000 € (njëqind e pesëdhjetë mijë euro)**.
2. Shuma minimale dhe maksimale për projekt përcaktohet në Thirrjen Publike.
3. Mjetet financiare mund të përdoren vetëm për aktivitetet e aprovuara në kontratë.

DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT

Dokumentet e Detyrueshme

Aplikacioni duhet të përmbajë:

1. Formularet e aplikimit të plotësuar (te shkarkohen formularet të publikuar ne faqen e Komuna Skenderaj të plotesohen të printohen të futen në zarf te mbyllur bashkë me dokumentet tjera të kërkuara)
2. Përshkrimin e projektit/programit;
3. Buxhetin e detajuar të projektit;
4. Certifikatën e regjistrimit të organizatës;
5. Deklaratën për mos-financim të dyfishtë;
6. Dokumente shitesë sipas kërkesës së Thirrjes Publike.
7. Vertetimin nga Gjykata qe nuk janë nën hetime
8. Vertetimin tatimor nga Atk qe nuk kanë borxhe

AFATI DHE MËNYRA E APLIKIMIT

Afati i Aplikimit

1. Afati për dorëzimin e aplikacioneve është **15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune** nga data e publikimit të Thirrjes Publike.
2. Aplikimet e dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Mënyra e Dorëzimit

Aplikimet dorëzohen:

- Fizikisht në Komunën e Skenderajt të mbyllura në zarf ne arkiven e Komunes në adresen ,Komuna Skenderaj rruga 28Nentori 41000 Skenderaj

VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA

Kriteret e Vlerësimit

Projektet vlerësohen sipas:

- Përputhshmërisë me qëllimin e thirrjes;
- Cilësisë dhe qartësisë së projektit
- Ndikimit në komunitet
- Realizueshmërisë së buxhetit
- Kapacitetit të aplikantit për zbatim

Shpallja e Rezultateve

Rezultatet publikohen në faqen zyrtare të Komunës së Skenderajt dhe në njoftimet e DKRS.

KONTRATA DHE RAPORTIMI

Obligimet e Përfituesve

1. Përfituesit nënshkruajnë kontratë financiare me DKRS.
2. Përfituesit janë të obliguar të dorëzojnë raporte narrative dhe financiare.

DISPOZITA FINALE

Hyrja në Fuqi

Ky Udhëzues hyn në fuqi ditën e publikimit të Thirrjes Publike.